



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITR	
02 Nr. / Br	289/20
Nr. i fq. / Br. sht	
Data: / Datum	12.03.2020
VUSHTRRI - VUČITR	




REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 67 "g" të Statutit të Komunës, në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Kosovës, nr. 01/07 lidhur me situatën e krijuar nga rreziku i përhapjes së korona virusit në Kosovë dhe me qëllim të ndërmarrjes së masave parandaluese në Komunën e Vushtrrisë, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Komuna e Vushtrrisë u bënë thirrje qytetarëve që sa më shumë që është e mundur të zvogëlojnë frekuentimin në zyrat komunale.
2. Inkurajohen qytetarët e komunës së Vushtrrisë që në komunikim të drejtpërdrejt me komunën të shfrytëzojnë linjën telefonike në Qendrën e thirrjeve të Komunës në numrin e tel. pa pagesë **0800 42000** për shërbimet që ata duan të marrin nga komuna. Aty do të marrin informatat e hollësishme për shërbimet që mund ti kryejnë.
3. Shërbimi në qendrën e thirrjeve është në dispozicion për qytetarë çdo ditë të javës, nga e hëna deri të premten, prej orës 08:00 deri 16:00.
4. Komuna pezullon shërbimin me palë në drejtoritë tjera me përjashtim të rasteve emergjente.
5. Të gjitha shërbimet e gjendjes civile dhe shërbimet tjera do të kryhen në sportelet në Qendrën e Shërbimit të Qytetarëve katin përdhes të Komunës.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
7. Zyra për informim e komunës do të bëjë publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të komunës. Gjithashtu të publikohen edhe numrat tjerë telefonik të drejtorive dhe zyrave përmes të cilëve qytetarët do të mund të drejtohen me pyetjet dhe kërkesat e tyre.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës